



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 16 Dhjetor 2020

Nr: 35

**VENDIM**

**PËR**

**MIRATIMIN E MODELIT DHE SPECIFIKIMEVE TË VULAVE ME KOD SIGURIE QË DO  
TË PËRDOREN NË ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 99, pika 2, shkronja “b”, nenin 100, paragrafi 4, dhe 101, paragrafi 1, shkronja “e”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi shqyrtoi propozimet dhe dokumentacionin e paraqitur

**VËRENE:**

Referuar nenit 19, paragrafi 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen atij me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Komisionit Rregulator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Referuar neneve 20 dhe 21 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ku përcaktohen kompetencat e Komisionit Rregulator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve në mënyrë shteruese, nuk përcaktohet kompetencë për miratimin e modeleve dhe specifikimeve të vulave me kode të sigurisë.

Ligji Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 99, përpërcakton detyrimin e KQZ-së për dërgimin në KZAZ të materialeve zgjedhore për çdo qendër votimi.

Në bazë të përcaktiveve të Kodit Zgjedhor, dispozitave si më poshtë referuar:

- a) nen 99, paragrafi 2, shkronja “b”, përcakton se KQZ dërgon në KZAZ numër të mjaftueshmë kodesh sigurie, sipas vendimit të KQZ-së;



Data: 23 Dhjetor 2020  
Nr. 2553

Për miratimin e specifikimeve të lëndës së posaçme për timbrimin e zgjedhësve për zgjedhjet për  
Kuvend të datës 25 Prill 2021

- b) neni 100, paragrafi 4, përcakton se: "Vulat me kodet e sigurisë dorëzohen me procesverbal të veçantë, në të cilin shënohen kodet e sigurisë për çdo vulë. KQV-ja merr në dorëzim aq vula me kode sigurie sa duhen për mbylljen e kutive të votimit dhe për mbylljen e kutisë me materiale zgjedhore, si dhe tri vula shtesë për përdorim vetëm në rast dëmtimi. Vulat shtesë duhet të kenë ngjyrë të ndryshme nga ato që do të përdoren si rregull për mbylljen e kutisë së votimit. Një kopje e procesverbalit, ku janë shënuar kodet e sigurisë, duke përfshirë edhe kodet shtesë të sigurisë, mbahet nga KZAZ-ja dhe një kopje i jepet KQV-së."
- c) neni 113, paragrafit 6, nënparagrafi i parë, përcakton se "Numrat e kodeve të sigurisë, me të cilët do të mbylljet kutia e votimit dhe kutia e materialeve të votimit, shënohen paraprakisht në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së."

Referuar eksperiencës të organizimit dhe administrimit të proceseve zgjedhore, vulat me kode sigurie të miratuar, prodhur, dhe përdorur nga KQZ kanë garantuar integritetin e materialeve sensitive të votimit siç janë kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit, sikundër edhe është dëshmuar lehtësi në administrimin dhe përdorimin e tyre nga komisionerët zgjedhorë, gjatë shpërndarjes, kryerjes së procedurave në qendrën e votimit, si dhe gjatë procesit të numërimit të votave. Vulat me kode sigurie të përdorura në proceset zgjedhore pararendëse, modeli dhe specifikimet teknike të tyre, janë testuar si të duhurat për sigurinë e kutive të votimit me fletët e votimit dhe kutive të materialeve të votimit.

Për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021, vulat me kode sigurie, përfshirë edhe vulat me kode sigurie rezervë:

- a) do të kenë trup prej materiali plastik, me ngjyrë, brenda të cilit ndodhet pllaka metalike që garanton mbylljen e sigurtë:
  - i. vulat me kod sigurie që do të përdoren për mbylljen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve të votimit do të kenë trup plastik me ngjyrë të bardhë;
  - ii. vulat shtesë me kod sigurie që do të përdoren për mbylljen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore do të kenë trup plastik me ngjyrë të verdhë.
- b) në trupin e vulës do të stampohet kodi i sigurisë me ngjyrë jeshile;
- c) kodi i sigurisë do të jetë KQZ dhe një numër unik gjashtë shifror për çdo vulë;
- c) mbyllja e vulës me kod sigurie do të bëhet me kavo çeliku të galvanizuar, i cili mund të këputet vetëm me përdorimin e një pince të posaçme.



## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja "n", dhe paragrapfin 2, nenin 99, paragrafi 2, shkronja "b", nenin 100, paragrafi 4, dhe nenin 101, paragrafi 1 shkronja "e", të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

## VENDOSA:

1. Të miratojë modelin dhe specifikimet teknike të vulave me kod sigurie, që do të përdoren për mbylljen e kutive të votimit me fletët e votimit dhe kutive të materialeve të votimit në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Vulat me kodet e sigurisë që do të përdoren për mbylljen e kutive të votimit me fletët e votimit dhe kutive të materialeve të votimit, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, do të kenë trupin plastik me ngjyrë të bardhë, ku me ngjyrë jeshile stampohet kodi i sigurisë.
3. Vulat shtesë me kod sigurie që do të përdoren vetëm në rast dëmtimi të vulave më ngjyrë bardhë, për mbylljen e kutive të votimit me fletët e votimit dhe kutive të materialeve të votimit, do të kenë trupin plastik me ngjyrë të verdhë ku me ngjyrë jeshile stampohet kodi i sigurisë.
4. Kodi i sigurisë është unik për çdo vulë dhe përbëhet nga 3 (tre) shkronja, KQZ, dhe një numër unik serial gjashtë shifror.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 23 Dhjetor 2020  
Nr. 2583

Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të vulave me kod sigurie që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021

## **LIDHJA 1**

1. Specifikit teknike të vulave me kod sigurie që do të përdoren për mbylljen e kutive të votimit me fletët e votimit dhe kutive të materialeve të votimit në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021:

### **1.1 Specifikit teknike të trupit të vulave me kod sigurie:**

- materiali plastik (ABS);
- përmasa 25 mm x 15 mm;
- ngjyrë të bardhë;
- ngjyrë të verdhë, për vulat shtesë me kod sigurie.


### **1.2 Kodi i sigurisë së vulës:**

- kodi i sigurisë është unik për çdo vulë dhe përbëhet nga 3 (tre) shkronja, KQZ, dhe një numër unik gjashtë shifror;
- do të stampohet me ngjyrë jeshile në trupin çdo vule.

### **1.3 mbyllja e vulës do të bëhet me kavo çeliku të galvanizuar:**

- diametër 1.8 mm;
- gjatësi jo më të vogël se 200 mm (6 x7 AF);
- mbyllja e telit të çelikut do të sigurohet nëpërmjet një pllakë metalike që ndodhet brenda trupit plastik të vulës.

### **1. Modeli i vulave me kod sigurie**



Data: 23 Dhjetor 2020  
Nr 2553

Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të vulave me kod sigurie që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021